



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 11 Shkurt 2022

Nr: 61

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 45, DATË 4.2.2022 “PËR CAKTIMIN E VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ NR. 2, NR. 3, NR. 4, NR. 5, NR. 19, NR. 21, NR. 22, NR. 23, NR. 24, NR. 26, NR. 43, NR. 54, NR. 55, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022”

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, neneve 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, 93, pika 1, dhe 94 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, janë caktuar me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 45, datë 4.2.2022, “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr. 54, nr. 55, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”, sipas lidhjes 1 të tij. Bazuar në listën e dërguar të objekteve nga Prefekti i qarkut Shkodër, për VNV e KZAZ-së nr. 5, është caktuar palestra e shkollës 9 –vjeçare “Edit Durham”.

Prefekti i qarkut Shkodër, me shkresën nr. 81/4 prot., datë 6.2.2022, në arsyetimin e tij, i mbështetur dhe në kërkesën e paraqitur nga KZAZ nr. 5, për palestrën e shkollës “Edit Durham” referon se:

- Në ambientet e palestrës janë instaluar pajisje gjimnastikore të cilat bëjnë të pamundur instalimin e pajisjeve që do të shërbejnë për procesin e numërimit të votave.

Për këtë arsye, prefekti i qarkut Shkodër referon si objekt për caktimin e VNV-së së ZAZ-së nr. 5 palestrën e shkollës 9-vjeçare “Xheladin Fishta”. Ky objekt ka shërbyer si VNV në zgjedhjet e mëparshme dhe



Data: 11 Shkurt 2022

Nr: 61

“Për një ndryshim në vendimin nr. 45, datë 4.2.2022 “Për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave të ZAZ nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 19, nr. 21, nr. 22, nr. 23, nr. 24, nr. 26, nr. 43, nr. 54, nr. 55, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

ZAZ nr. 5 ka 47 (dyzet e shtatë) QV dhe mjedisi në këtë objekt, me sipërfaqe 500 m², plotëson kriteret teknike të përcaktuara në Vendimin e Komisionit Rregullator nr. 3, datë 9.2.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, 93, pika 1, dhe 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Në lidhjen 1 që i bashkëlidhet vendimit nr. 45, datë 4.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:
 - a) Në Qarkun Shkodër, bashkia Shkodër, në KZAZ-në nr. 5, objekti i propozuar për VNV, palestra e shkollës 9-vjeçare “Edit Durham”, zëvendësohet me palestra e Shkollës 9-vjeçare “Xheladin Fishta”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

